

ERJENA LAMAJ (CENKA)

VËZHGIME LEKSIKORE TE ROMANI “JETË NË NJË KUTI SHKREPËSESH” TË F. KONGOLIT

Romani “*Jetë në një kuti shkrepësesh*” i shkrimtarit Fatos Kongoli shquhet për një gjuhë të pastër, të rrjedhshme, për një sintaksë tërheqëse. Tërheqin vëmendjen në këtë vepër shumëllojshmëria e lidhjeve të fjalëve të shqipes, shpesh të njohura, duke ripohuar edhe një herë për mundësitë e mëdha shënuese, por në radhë të parë shprehëse, të gjuhës.

Leksiku i gjuhës shqipe, sipas prof. J. Thomait, nuk është një grumbull i thjeshtë fjalësh, por një sistem njësisht, që klasifikohen sipas parimeve të ndryshme¹. Kështu, edhe leksikun e vjelë nga romani “*Jetë në një kuti shkrepësesh*” i Fatos Kongolit, ne mund ta grupojmë e ta nëngrupojmë për të parë për qëllime analize e studime karakterin e tij sistemor.

Leksikun e romanit mund ta ndajmë në dy grupe të mëdha: në leksikun e shqipes, të cilin e ka shfrytëzuar artistikisht për të realizuar përmbajtjen e veprës; si dhe në leksikun e krijuar prej tij si autor, për të plotësuar zbrazëtitë në leksikun e shqipes ose për të formësuar idetë e konceptet e reja që krijuesit i kanë lindur gjatë procesit të shkruarit të veprës.

Një aspekt tjetër i vlerësimit të leksikut mbetet dhe karakteri i tij burimor, duke u vënë theksi sidomos te huazimet. Ato tregojnë një gjendje

¹ Sipas akademiku J. Thomai, “Leksiku mund të grupohet sipas burimit të fjalëve, që nënkupton dy grupe paradigmatiche të mëdha njësisht: *grupi i njësisve leksikore që lidhen me leksikun amtari (autokton)* dhe *grupi i njësisve leksikore të huazuara*; - mund të grupohet sipas dendurisë së përdorimit, që nënkupton larmi kriteresh dhe për pasojë edhe larmi grupimesh, si: *grupi paradigmatic i leksikut aktiv* dhe *grupi paradigmatic i leksikut pasiv*.

- mund të grupohet edhe sipas marrëdhënieve me normën e gjuhës standarde, që nënkupton dy grupe të mëdha njësisht leksikore: *grupin e njësisve që janë normë* dhe *grupin e njësisve që nuk janë normë*.

- Studiuesi i gjuhës nuk mund të anashkalojë shqyrtimin e këtij leksiku sipas sferës së përdorimit. Ai bën objekt shtresën e fjalëve të reja në gjuhën shqipe, shtresën e fjalëve që njihen nga një grup i caktuar njerëzish, fjalët dialektore e krahinore.” Shih me gjerë J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 245 -302.

të caktuar dhe shërbejnë për të karakterizuar personazhet dhe mjediset ku ato veprojnë.

Leksiku i vjelë nga romani, i parë edhe semantikisht, përgjithësisht, krijon grupime e shtresa të tilla, si: fjalë me kuptim konkret, me kuptim abstrakt, me kuptim të figurshëm etj. Interesante janë edhe formimet e pathjeshta, të cilat dalin me vlera stilistikore, por edhe me vlera shënuese dhe duhet zënë vend në kartotekën e leksikut të gjuhës shqipe

Duke marrë parasysh shqyrtimet dhe klasifikimet e derisotme për gjuhën shqipe dhe më gjerë, ne përzgjedhëm për të dhënë këtu disa grupe që përfshihen në leksikun e një nga romanet më të njohur të shkrimtarit Fatos Kongoli, i cili dallohet për një begati e madhe leksikore.

Grupi i njësive që përfshihen në leksikun e mbarëshqipes

Akademik J. Thomai thekson se “Në leksikun e gjuhës shqipe dhe në fjalorin që përdor çdo njeri, dallohen dy shtresa: një shtresë fjalësh aktive, që njihen mirë e përdoren shpesh në punët e përditshme e në jetën e zakonshme dhe një shtresë fjalësh që s’ njihen prej të gjithëve ose, megjithëse njihen, s’përdoren; në vend të tyre përdoren fjalë të tjera. Kështu, për të gjithë janë të njohura fjalët *i bukur, diell, eci, jam, kam, kohë, lart, mirë, nënë, njeri, pemë, punoj, tokë, them, i zi* etj.; ato përdoren shpesh dhe përbëjnë shtresën e përdorimit të përbashkët të leksikut; kurse fjalë, si: *dac, frezë, krrej, lëpitkë, mbodhisem, pishtoll, poronicë, punto, tabare, tyl, uzdajë, vatan, zaman ...*, nuk janë të përdorimit të përgjithshëm. Po të flasim për njerëz që punojnë në fusha të veçanta, atëherë del, p.sh., që mekaniku njih mirë e përdor përditë terminologjinë teknike të mjeshtërisë së tij, kurse bujku ato të punës së vet, mjeku të tjera fjalë etj. Çdo njeri ka fondin aktiv dhe fondin pasiv të fjalëve.”²

Dhe në romanin **“Jetë në një kuti shkrepësesh”** të Fatos Kongolit ne gjejmë fjalë të leksikut të përgjithshëm, të leksikut aktiv, që janë të njohura nga shumica e shqipfolësve e që janë përdorur artistikisht në vepër.

Në vijim po japim, përmes përdorimeve në fjali, fjalë që i takojnë këtij leksiku:

Ndonjëherë rrinte gjatë, gjithmonë në pjesën ku shërbente Dina, në një tryezë afër faqes së xhamtë. Tryeza ku ulej i përkiste zonës së Dinës, madje kësaj të fundit nuk i dinte as emrin. Pastaj mbërriti një çast dhe, pashmangshmërisht, ia mësoi emrin.

² J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 264.

*Punonte në kanalin televiziv “Sirius” dhe **intervistonte** politikanë e personalitete të larta.*

*Nisur nga zelli i veçantë i saj për t’i shërbyer dhe fakti se i prishej **frymëmarrja** kur fliste me të, atij iu duk e natyrshme ta ftonte të pinin një kafe bashkë.*

*Një pasdite ajo e njoftoi për **mbërritjen** e saj me anë të citofonit. Sapo i dëgjoi zërin, ai u ngut t’i hapte derën e hyrjes.*

*Dina nuk e kuptoi përse tjetri nuk e pa të nevojshme t’i bënte këtë **saktësim**.*

*Portreti i **kudondodhur** i gruas, - ai gjendej edhe mbi një komedinë në dhomën e gjumit, pra në shtratin ku bënë dashuri, - nuk e shqetësonte.*

*Kamerierja, e **hutuar** dhe e **bezdisur**, u përpoq t’i jepte bisedës ngjyrë shakaje. Unë s’kam arsye të mendoj kështu vetëm se, sipas gjykimit tënd, ish-bashkëshortja jote ... më fal...*

*Femra me të cilën **ke bashkëjetuar** nja dy vjet, nuk dinte të pallohej, ndërsa unë di.*

*Pavarësisht se, siç ia kishte pohuar çiltërsisht, ai pallonte bukur, me një energji të **papërballueshme**. Ndoshta për këtë arsye ajo e shkeli vendimin e saj që të nesërmen.*

Grupi i fjalëve që përfshihen në leksikun e krijuar nga F. Kongoli

Në përgjithësi fjalët që krijohen nga një subjekt quhen neologjizma dhe ato mbeten si të tilla derisa nuk janë bërë pronë e pjesës dërrmuese të shqipfolësve. Në romanin “Jetë në një kuti shkrepësesh”, kemi fjalë të reja, një pjesë mund të jenë krijuar nga shkrimtari Fatos Kongoli, kurse një pjesë tjetër janë futur në roman nga Fatos Kongoli, por që nuk gjenden në fjalorët e shqipes. Në këtë këndvështrim ato dalin si fjalë të reja.

Akademik Jani Thomai shkruan se “Neologjizmat mund të kenë burim popullor dhe atëherë mbeten anonimë. Por shumë herë fjalët e reja krijohen nga autorë, që përpiqen të pastrojnë dhe të pasurojnë leksikun e gjuhës. Shkrimet shqipe, që nga më të hershmet, na dëshmojnë se në gjuhën tonë janë krijuar e kanë hyrë në përdorim shumë fjalë të reja, që e kanë zgjeruar leksikun e saj. Edhe në ditët tona leksiku i shqipes është pasuruar me shumë fjalë e shprehje të reja si kërkesë e zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor, si: *bashkëbisedim, bashkëjetesë, dytësor, katengjitës “ashensor”, mëngjesore, mbarëvajtje, parësor, parimorësi, përparësi, rëndesë, shumëgarësh, vetëqeverim, vetëvendosje ...* Te kapitulli për grupet paradigmatiche të fjalëve sipas formimit (me ndajshtesa, pa ndajshtesa, me

përbërje e me përngjitje) kemi folur gjerësisht se si krijohen fjalët e reja në gjuhën shqipe.”³

Dhe ai vazhdon më poshtë “Fjalët e reja ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare. Fjalë të shpikura kot, pa një mbështetje a pa një gjedhe të njohur, zakonisht nuk ka. Në fjalën e re kemi njësim të së vjetrës me të renë: të vjetra janë mjetet fjalëformuese që e përbëjnë atë; e re është vetë fjala; i ri është edhe kuptimi i saj, krahasuar me kuptimin e pjesëve përbërëse; p.sh., deri në kohën e Rilindjes nuk njiheshin fjalët *dhe shkronjë, përemër* etj., por fjalët *dhe, shkronjë, për dhe emër* njiheshin. Na duket ndonjëherë se fjala e re ka dalë rastësisht, ndërsa në të vërtetë në formimin e saj kanë vepruar ligjet e brendshme të gjuhës. Vetë kërkesat e jetës e të shoqërisë janë shkaku që të lindin fjalë të reja dhe ato formohen, duke u mbështetur në pasurinë e gjuhës e sipas ligjeve të saj.”⁴

Në vijim po japim disa thënie ku njësitë me të zeza, për Kartotekën e leksikut të shqipes dalin si njësi të reja:

Dje në mëngjes im atë më mori në telefon. “Jot ëmë është shumë e mërzitur, më tha, nuk duhet ta torturosh kështu. Ke një muaj pa ardhur. ”Jo një muaj, ia ktheva unë në një orvatje për ta zh dramaturgizuar situatën, vetëm një javë.

Ja ngaqë atë çast im kunat ishte personi i fundit për të cilin dëshiroja të flisja, ja ngaqë Jana kishte përdorur fjalën mut e kjo më zhbaraspeshoi.

Më tej, për të thyer memecërinë time, Jana zuri të më tregonte një histori. Më paralajmëroi, nuk ishte e lexuar te revista “Eros”.

Unë vazhdova të mbyllesha në memecllëkun tim. Ajo, sidoqoftë, vendosi të ma tregonte historinë, që ishte e vërtetë dhe jo e lexuar te revista “Eros”.

Sipas ekspertëve të vetëshpallur imobiliarë të lagjes, vlera e një apartamenti në zonën ku banonim ne, me rrugicat tërë pellgje kutërbuese në verë e në dimër, ngatërrimin e ujërave të zeza me ujëra të bardha, përmytjen e bodrumeve për shkak të bllokimit të kolektorëve nga ndërtimet pa leje, shkonte, e shumta, deri në dyzet milionë.

Një etiketë mbi derë do t’i orientonte borxhdhënësit ose armiqet e mundshëm.

Tringëllima u përsërit. Ai u përqendrua, kësaj radhe vëmendshëm, dhe nuk e vuri më në dyshim. Dikush shtypte sustën e ziles.

³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 267-268.

⁴ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 268.

Tringëllima u përsërit. Ai u përqendrua, kësaj radhe vëmendshëm, dhe nuk e vuri më në dyshim. Dikush shtypte sustën e ziles.

Grupi i fjalëve që përfshihen në leksikun me kuptime konkrete

Prof. J. Thomai thotë se në gjuhë dallojmë “kuptime **konkrete** dhe kuptime **abstrakte**. Dallimi i këtyre kuptimeve bëhet thjesht sipas natyrës së realieve që shënohen nga fjalët përkatëse dhe sipas mënyrës se si i perceptojmë ato realie. Pra, janë konkrete ato kuptime që u referohen realieve të perceptueshme me anë të shqisave; p.sh. kuptimet e para konkrete të fjalëve *bardhësi* (*bardhësia* e borës ...), *bimë*, *dru*, *gur*, *hënë*, *ngjyrë*, *njeri*, *zhurmë*... ose të prejardhura, si te *bishti i karvanit*, *dylli i veshit*, *gur shahu*, *këmba e karriges*, *krahu i aeroplanit* ...”⁵

Kuptimi abstrakt mund të jetë kuptim i përgjithshëm, si tek emrat e veprimt, tek emrat e cilësisë etj., dhe kuptim i prejardhur, si në shembujt e mësipërm e në fjalë të tjera të ngjashme. Në rrafshin teorik të përgjithshëm, mbiemrat, foljet, ndajfoljet etj. merren si klasa fjalësh me kuptim abstrakt, sepse shënojnë cilësi e veprime, por në rrafshin konkret pranohet që në këto klasa fjalësh ka kuptime konkrete, kur shënohen tipare a veprime të perceptueshme me shqisa; p.sh. *bardhë* (*i*, *e*) *mb.* me kuptimin abstrakt të cilësisë dhe me kuptimin konkret të ngjyrës (*mur i bardhë* ...); *sharroj kal.* me kuptimin abstrakt të veprimt dhe me kuptimin konkret të lëvizjeve që shihen (kur *sharrojmë dru* ...), por përsëri me kuptim abstrakt kur themi “*sharrova për të ngrënë*”, “*sharroj nga malli*” ...⁶

Në roman gjejmë shumë njësi me kuptim konkret:

Sipas ekspertëve të vetëshpallur imobiliarë të lagjes, vlera e një apartamenti në zonën ku banonim ne, me rrugicat tërë pellgje kutërbuese në verë e në dimër, ngatërrimin e ujërave të zeza me ujëra të bardha, përmytjen e bodrumeve për shkak të bllokimit të kolektorëve nga ndërtime pa leje, shkonte, e shumta, deri në dyzet milionë.

Sipas ekspertëve të vetëshpallur imobiliarë të lagjes, vlera e një apartamenti në zonën ku banonim ne, me rrugicat tërë pellgje kutërbuese në verë e në dimër, ngatërrimin e ujërave të zeza me ujëra të bardha, përmytjen e bodrumeve për shkak të bllokimit të kolektorëve nga ndërtime pa leje, shkonte, e shumta, deri në dyzet milionë.

⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 146-147.

⁶ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 146-147.

Sjellja e tyre e tërhequr u vulos kur në vend të derës së jashtme prej druri, vendosën një derë të **blinduar**, gjithnjë pa etiketë. Kjo përfaqësonte blindim të kufijve.

Një etiketë mbi derë do t'i orientonte **borxhdhënësit** ose armiq të mundshëm.

Një specialist që erdhi ta montonte bashkë me **printerin**, në vend të fjalëve “është ca i përdorur”, tha “është ca i **vrrarë**”.

Ajo zgjodhi **kapuçino**, unë një teke konjak. Ndërsa ajo gjerbte kapuçinon, unë konjakun, nuk e mohoj, truri imë filloi të fantazonte.

U ul te karrigia e **rrotullueshme**, përballë ekranit. Dhe përballë portretit të biondes mbi mur. “Nuk kam frikë prej teje”, i tha.

Më ka mbetur në dorë si dopio-gjashta ky apartament. **I mobiluar**, po ashtu, sipas dëshirave dhe gustove të saj.

Përfytyroni një prokuror të shtetit që, papritur, pajiset me parashtesën ish. Im kunat, si të gjithë “ish”- at, - kujtoi se edhe im atë, duke u futur në kategorinë e **ish-pronarëve**, në një farë mënyre u pajis me parashtesën “ish”.

Në vend të **zhgunit**, murgu mbante veshur një kostum veror prej cohe të bardhë, të zhubrosur, tërë njolla.

Një punëtor i komunes së lagjes, i quajtur, Tahir, pas shiut priste sa të thaheshin tjegullat dhe ngjitej mbi çatitë e të gjithë pallateve për të zënë **gjerbat**.

Dhe një lukuni e pafund femrash lakuriq, me **organet seksuale** të fshehura nën vete, të mbuluara nga **shkurraja** të zeza.

Grupi i fjalëve që përfshihen në leksikun me kuptime abstrakte

Sipas akademik J. Thomai “Kuptimet abstrakte u referohen realieve të perceptueshme mendërisht, intelektualisht, si te *bardhësi* “të qenët i bardhë”, *besim*, *durim*, të folurit “aftësia e njeriut për të folur”, *lumturi*, *mendim*, *punë*, *shpejtësi*, *vuajtje*, *zhurmë* “bujë rreth dikujt a diçkaje për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve”⁷.

Sjellja e tyre e tërhequr u vulos kur në vend të derës së jashtme prej druri, vendosën një derë të blinduar, gjithnjë pa etiketë. Kjo përfaqësonte **blindim** të kufijve.

Nuk e bëra këtë marrëzi, Jo vetëm sepse **paturpësia** ime mund të shpërblehej me një shuplakë.

⁷ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 148.

Me t’i parë, Suela u tall. “Prodhime kineze, më tha, i ke blerë te çamët. “Në seancat tona të fundjavës unë nuk u vesha më me mallra të blera te çamët.

*Unë vazhdova të mbyllesha në **memecllëkun** tim. Ajo, sidoqoftë, vendosi të ma tregonte historinë, që ishte e vërtetë dhe jo e lexuar te revista “Eros”.*

*Ja ngaqë atë çast im kunat ishte personi i fundit për të cilin dëshiroja të flisja, ja ngaqë Jana kishte përdorur fjalën mut e kjo më **zhbaraspeshoi**.*

*Më tej, për të thyer **memecërinë** time, Jana zuri të më tregonte një histori. Më paralajmëroi, nuk ishte e lexuar te revista “Eros”.*

*Ajo më la gazetën në dorë. Sytë e mi **u përthithën** nga shkronjat e mëdha ngjyrë rozë të kokës “Eros”.*

*Veprimi i parë **statukuoprishës** i banorit të ri ishte rrethimi i kopshtit nën dritaren e apartamentit të tij.*

Grupi i fjalëve që përfshihen në leksikun me kuptime të figurshme

Sipas prof. J. Thomait “Si kriter dallues i këtyre kuptimeve merret mënyra si shënohet realia. Kur realia shënohet drejtpërdrejt, pa ndërmjetësinë e ndonjë realieje tjetër, atëherë te fjala emërtuese kemi kuptim të drejtpërdrejtë; p.sh., *mash/ë-a f.* “përdorëse hekuri, zakonisht me dy krahë të gjatë, me të cilat kapim thëngjij etj. (kap me *mashë* ...)”; *trëndafiltë (i, e) mb.* “që ka ngjyrën e trëndafilit (fustan i *trëndafiltë* ...)”; *tërbohem vetv.* “më zë tërbimi (u *tërbua* qeni ...)” etj. Kuptimet e drejtpërdrejta zakonisht janë të parme, por mund të jenë edhe të prejardhura, si tek emrat foljorë të veprimit. Kur realia shënohet në mënyrë të ndërmjetuar, nëpërmjet një realieje tjetër, atëherë te fjala emërtuese kemi kuptim të figurshëm; p.sh., *mash/ë-a f. (keq.)* “njeri që përdoret nga dikush si vegël për të kryer punët e veta (u bë *mashë* e tij ...)”; *trëndafiltë (i, e) mb.* “që sjell lumturi, që na gëzon zemrën, që na ngjall shpresa të bukura (ëndrra të *trëndafila* ...)”; *tërbohem vetv.* “sillem si i papërmbytur për të plotësuar dëshirat a tekat e mia, pasi më kanë përkëdhelur shumë, harbohem (*është tërbuar* nga të mirat ...)” etj.”⁸

Dhe më poshtë profesori vazhdon “Kuptimet e figurshme janë zakonisht të prejardhura. Të tilla janë edhe kuptimet te disa fjalë të përbëra, si *buzëplasur, gojështhurur, gjuhëlopatë, kokëshkëmb, krahëhapur, i pacipë, i pafytyrë, pikërenë, varrhumbur, zemërgur* etj. Siç

⁸ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 148.

shihet, kuptimet e figurshme zhvillohen sipas tropeve gjuhësore (sipas krahasimit, metaforës, metonimisë, sinekdokës, hiperbolës etj.). Si kuptime të figurshme merren edhe kuptimet frazeologjike, d.m.th. ato kuptime që fjalët i kanë në struktura të detyrueshme frazeologjike; p.sh., te *bëj pallë* fjala *pallë* ka kuptim “qejl”; *shes mend* ka kuptimin “i jap një tjetri këshilla a dituri për të mburrur veten” etj. Meqenëse njësitë frazeologjike janë përgjithësisht të figurshme, atëherë edhe kuptimet e gjymtyrëve të tyre (kur këto mund të veçohen kuptimisht) janë të figurshme. Por mundësia e veçimit kuptimor të gjymtyrëve të njësitë frazeologjike është e vogël, pasi tek ato kuptimet e gjymtyrëve janë shkruar në një, në kuptimin e së tërës, të të gjithë njësisë, e cila si një e tërë ka kuptim të figurshëm.”⁹

Po japim disa fjalë me kuptim të figurshëm nga romani, duke qenë të vetëdijshëm se në një vepër prozaikë fjalët me kuptim të tillë janë më të kufizuara:

Kur Jana vishej kështu me një tualet, me një tualet disi të ngarkuar, me një të kuq buzësh që anonte më shumë nga ngjyra kafe, unë e dëshiroja qenërisht.

Vështirë të përfytyroje pastaj që pjesët e përgjumura, kaba, të trupit të saj, në shtrat zgjoheshin, fitonin agresivitet.

Punët e qiellit, me shenjtorë të rremë apo të vërtetë, ai nuk i merrte as shumë seriozisht, as me shumë pasion, si i ndjeri Sotir.

“Je njeri i leksuar, i tha Sotiri tim eti, pa ja hequr sytë shën Mërisë, besoi ta dish historinë e Qezarit me Brutin.

Majtas, shkallët të zbrisnin në bodrum. Diçka më dritëzoi në brendësi të trurit, por u shua. “Ik, i thashë vetes, ik!”

Huazimet

Në romanin “Jetë në një kuti shkrepësesh” të Fatos Kongolit gjejmë jo pak huazime, të cilat më shumë se huazime të autorit janë huazime që i kanë thithur ligjërimet e ndryshme të shqipes. Shkrimtari vetëm i ka futur në gjuhën artistike.

Profesor J. Thomai shkruan se “Huazimi leksikor më i zakonshëm dhe më i përhapur në gjuhën shqipe është *huazimi i fjalëve bashkë me sendet a me konceptet e reja*. Në qoftë se për ne bëhet i njohur një objekt ose një koncept i panjohur, atëherë në leksik hyn edhe emërtimi për të, sipas gjuhës nga e cila vjen. Kështu janë huazuar nga italishtja fjalët *bankë, buletin, sonet...*; nga anglishtja fjalët *basketboll, boks, gol, volejboll ...*

⁹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 148.

Këto janë *huazime historiko-kulturore*. Kur fjalët e huazuara nuk hyjnë bashkë me sendet e me konceptet e reja, po *bashkëpërdoren si sinonime me fjalët e vendit, kemi huazime gjuhësore*.¹⁰

Profesor Xhevat Lloshi shkruan se “Për stilistikën kanë vlera shprehëse huazimet, për të cilat bëhet e dukshme që janë diçka e huaj kundrejt brumit të shqipes ose tekstit rrethues shqip. Rrjedhimisht, huazimi i veçuar kërkon përftesa të posaçme që ta tërheqë vëmendjen te ky vështrim nga prejardhja: ruhet trajta shkrimore, ndonjë veçori tingullore ose fonetike, jepen togje të tëra sintaksore, shoqërohet me fjalën përkatëse shqipe ose me shpjegime të tjera.”¹¹

Duhet të themi se në roman këto lloj njësisish varen plotësisht nga gjuha e prozës, nga ngjarjet që ndodhin në roman si dhe nga përkatësia shoqërore e personazheve që veprojnë në roman.

*Vajti në dhomën e gjumit, hapi dhe atje dritaren, veshi një bluzë, një palë pantallona **xhins** dhe ndezi për pak sekonda dritën e abazhurit mbi komodinën te koka e krevatit.*(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 19)

*Vajti në dhomën e gjumit, hapi dhe atje dritaren, veshi një bluzë, një palë pantallona **xhins** dhe ndezi për pak sekonda dritën e abazhurit mbi komodinën te koka e krevatit.*(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 19)

*Vajti në dhomën e gjumit, hapi dhe atje dritaren, veshi një bluzë, një palë pantallona **xhins** dhe ndezi për pak sekonda dritën e abazhurit mbi **komodinën** te koka e krevatit.*(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 19)

*Nëse arrinte ta zbriste pa rënë në sy trupin e romes pa rënë poshtë, - në **parkingun** prapa pallatit gjendej vetura e tij, - gjithçka mund të quhej e **mbaruar**.* (Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 19)

*Ndërsa ti, debile, do të kesh rastin të bëhesh e njohur botërisht. **Post mortum**, siç thuhet, pas vdekjes.*(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 20)

*Shpall botërisht se prindërit e mi janë martuar me dashuri. Shpresoj t’u bëhet qejfi nga ky njoftim dhe të më falni për hollësitë e pakëndshme **nokturne** që përmenda më sipër.*(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 33)

¹⁰ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 276.

¹¹ Xh. Lloshi, *Stilistikë e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 97.

Në rastin më të zakonshëm të vendosura përtokë, në një qoshe të banjës, si rregull **allaturka**. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 33)

Dy kanate prej qelqi të trashë, mbërthyer në korniza metalike **inoksidabël**, që hapeshin e mbylleshin, e izolonin nga pjesa tjetër e banjës. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 33)

“O **idiot**, ulërinte, o **debil**, më le pa vajtur në shkollë.” Anila tërbohej më shumë edhe për një arsye tjetër. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 57)

“O **idiot**, ulërinte, o **debil**, më le pa vajtur në shkollë.” Anila tërbohej më shumë edhe për një arsye tjetër. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 57)

Sapo doli në superstradë, ndeshi një **lavazh**. Në kohën që dy djem, të dy gabelë, me lëvizje energjike zunë të lanin “Benz”-in, ai u hoq mënjanë. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”..., f. 128)

Emërtimet e pathjeshta

Në fjalorë gjejmë dhe një grup njësisht të pathjeshta, që dalin me strukturë togfjalëshi me dy gjymtyrë. Ato janë me rëndësi të madhe jo vetëm për vlerat shënuese, por në hartimin e fjalorëve, ato shërbejnë për të plotësuar çerdhen semantike të një fjale që është gjymtyrë e këtyre emërtimeve:

Më poshtë po japim përmes thënieve njësi të tilla:

Fatos Kongoli, “Jetë në një **kuti shkrepësesh**”, Tiranë, 2007, Shtëpia Botuese “Toena”, titulli i romanit.

Ndërsa ti, **debile**, do të kesh rastin të bëhesh e njohur botërisht. **Post mortum**, siç thuhet, pas vdekjes. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 20)

Qetësia iluzive e pak çasteve më parë e braktisi dhe ai ra sërish pre e një **ankthi të zi**. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 17)

Në epokën paramoderne, ose parahistorike, quheni si të doni, për të larguar syrin e të ligut, - nuk përjashtohet mundësia që i ligu të depërtonte edhe në shtëpinë tonë, - te **dhoma e pritjes**, në vend të shën Mërisë, ata mbanin ikonën zyrtare. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 28 – 29)

Duhet të kem qenë në klasën e dytë fillore dhe, ndërkaq, në biseda me moshatarët e mi, unë mbroja një **tezë hyjnore**: të gjithë ne kishim lindur nga sqetulla e nënës. (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”... f. 30)

Punonte në **komitetin e partisë** të rrethit. Me këtë shpjegohet përse fjala e tij në shtëpinë tonë peshonte.(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 60)

Gjelin e detit me pilaf ne e shtynim nja dy – tri ditë. Si rregull, mua më takonin kofshët. Mishin e bardhë të gjoksit e merrte Anila, trashkofshët nëna, bythën dhe krahët, im atë.(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 62)

Për të parë më mirë, më vinte në ndihmë një **llambë elektrike** në qendër të tavanit, nën të cilin krijova mjedisin tim bodrumor:(Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”... f. 67)

E keqja, mendoi, është se unë nuk ndodhem këtu për të ushqyer një **kronikë rozë**. Ndodhem për një kronikë të zezë. (Fatos Kongoli, “*Jetë në një kuti shkrepësesh*, f. 79)

Si përfundim, mund të themi, se mjafton dhe kjo paraqitje e përgjithshme, taksonimike, e disa grupeve paradigmatiche të pasurisë leksikore të romanit “*Jetë në një kuti shkrepësesh*”, për të parë vlerat e tyre shënuese, por veçanërisht ato shprehëse, duke e bërë romanin një vepër të rëndësishme në përmbajtje dhe në rrafshin gjuhësor të shprehjes.

